

VENDIM

Nr. 5, datë 30.04.2021

MBI

“MIRATIMIN PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË ‘MUZIKOLOGJI’, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI KOMPOZICION-MUZIKOLOGJI-DIRIZHIM-PEDAGOGJI MUZIKORE PRANË FAKULTETIT TË MUZIKËS, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të vecantë Universitetit të Arteve, si Institucion i vetëm Publik i Arsimit të Lartë, në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019); Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 9, datë 27.04.2021 “Mbi miratimin paraprak për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të doktoraturës ‘Muzikologji’, të paraqitur me shkresën nr. 67 prot., datë 21.04.2021 (të protokolluar në Rektorat me nr. 430 prot., datë 21.04.2021), nga Departamenti Kompozicion-Muzikologji-Dirizhim-Pedagogji Muzikore pranë Fakultetit të Muzikës”; si dhe në shkresën me nr. 493 prot., datë 27.04.2021 të Kryetarit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, Prof. Kastriot Çausi, me lëndë “Përcjellje për miratim të VSA nr. 9, datë 27.04.20021”, drejtuar Bordit të Administrimit së UART dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi dokumentacionin e paraqitur nga FM, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimit të Doktoratës “Muzikologji”, të paraqitur nga Departamenti Kompozicion-Muzikologji-Dirizhim-Pedagogji Muzikore pranë Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim të dërgohet sipas procedurës të përcaktuar në Udhëzimin nr. 1, datë 14/01/2020..

